



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

VENDIM
Nr.390, datë 17.12.2021

PËR CAKTIM TË PËRKOHSHËM

Bazuar në nenin 149/a të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenin 59 pika 1 dhe 4, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në nenet 164 pika 8, 166 pika 2, 189 pika 1, germa “a” të Ligjit nr.115/2016 “Për Organet e Qeverisjes së Sistemit të Drejtësisë”, i ndryshuar, në Rregulloren “Për caktimin e përkohshëm të prokurorëve”, e ndryshuar, si dhe në relacionin shpjegues të përgatitur nga Komisioni për Zhvillimin e Karrierës, Këshilli i Lartë i Prokurorisë,

V E N D O S I:

1. **Z. Elion Mustafaj**, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Lushnje, të caktohet përkohësisht të ushtrojë funksionin e Drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Lushnje.
2. Z. Elion Mustafaj, do të ushtrojë funksionin e Drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Lushnje, nga data 24.12.2021 - 23.03.2022.
3. Për periudhën e përmendur në pikën 2, Z. Elion Mustafaj do të paguhet me pagën e pozicionit të Drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Lushnje.
4. Të njoftohen për këtë vendim Z. Elion Mustafaj, Prokurori i Përgjithshëm dhe Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Lushnje.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Këshillit.

KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË



KRYETAR
GENT IBRAHIMI

ANËTAR
KOSTAQ BELURI

ANËTAR
ELOIDA GOXHI

ANËTAR
VATË STAKA

ANËTAR
BUJAR SHESHI

ANËTAR
ESMERALDA KESHI

ANËTAR
SANDËR BECI

ZV/KRYETAR
ALFRED BALLA

ANËTAR
NURIHAN SEITI

ANËTAR
MOISI DUDA

ANËTAR
TARTAR BAZAJ